

REPUBLIKA E KOSOVËS/RPUBLIKA KOSOVA/ RPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KOSOVARE kundër-KORRUPSIONIT			
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU			
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	<u>Z-0</u>	Br.Prot.	<u>01-723/09</u>
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	<u>3page</u>	Datum	<u>27-05-09</u>
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E LIDHUR NË MES TË

AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

DHE

AVOKATIT TË POPULLIT

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit (këtu e tutje Agjensioni) dhe Avokati i Popullit,

Pranojnë që është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë me qëllim të shkëmbimit të informatave, në përputhje me mandatet përkatëse, në mes të Agjensionit dhe Avokatit të Popullit, në mënyrë që të sigurohet një luftim më i efektshëm i fenomeneve korruptive dhe mbrojtje e të drejtave të njeriut.

Prandaj arrijnë këtë marrëveshje.

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Marrëveshja do të kontribuojë për të siguruar një bashkëpunim efektiv në mes të Agjensionit dhe Avokatit të Popullit në shkëmbimin e informatave lidhur me çështjet që bien nën mandatin e të dyja institucioneve që do të kontribuonte në luftimin e dukurive korruptive dhe mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut në mes të dy institucioneve përkatëse.

ZBATIMI I MARRËVESHJES

1. Avokati i Popullit zotohet ti dërgojë Agjensionit ankesat e pranuar të qytetareve në lidhje me dyshimet për veprime korruptive (përmes Udhëheqësit të saj), për vlerësimin e tyre, sipas mandatit të përcaktuar me ligj. Avokati i Popullit do të njoftojë Agjensionin edhe në lidhje me të dhënat e raportuesit të rastit me qëllim të lehtësimit të hetimit nga Agjensionin.
2. Agjensionin konform mandatit të tij, do të ndërmarrë veprimet hetimore për hetimin e rasteve të raportuara nga qytetarët të Avokatit të Popullit të cilat i janë dërguar Agjensionit.
3. Me kërkesën e Agjensionit, apo edhe me iniciativën e vet, Avokati i Popullit do ti ofrojë të dhëna plotësuese në lidhje me rastin i cili është adresuar në Agjension.
4. Agjensionin do ta njoftojë Avokatin e Popullit dhe qytetarin që ka raportuar rastin specifik në lidhje me rezultatin përfundimtar të hetimeve.
5. Agjensionin do ti dërgojë ankesat e pranuar të qytetareve për shkelje të të drejtave të njeriut të Avokatit të Popullit (përmes Drejtorit të saj), për vlerësimin e tyre, sipas mandatit të përcaktuar me ligj.
6. Avokati i Popullit do ta njoftojë Agjensionin në lidhje me rezultatin përfundimtar të hetimit për shkeljen e të drejtave të njeriut për rastet e dërguara nga Agjensionin.
7. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, apo edhe me iniciativën e vet, Agjensionin, do ti ofrojë të dhëna plotësuese në lidhje me rastin i cili është dërguar në Avokatin e Popullit.
8. Te dyja institucionet mund të mbajnë takime të përbashkëta sipas nevojës për shqyrtim të gjithanshëm të çështjeve që janë nën mandatin e njërit apo të dyja institucioneve me qëllim të ofrimit të zgjedhjes efektive.
9. Për implementimin e kësaj marrëveshjeje, të dy palët caktojnë Zyrtarët përkatës kontaktues.

DETYRAT E PALËVE


10. Agjensioni dhe Avokati i Popullit detyrohen të ruajnë informacionin dhe ta trajtojnë atë si informacion konfidencial konform ligjit deri në përfundimin e hetimit.
11. Palët do ta ekzekutojnë këtë marrëveshje në mirëbesim dhe të gjithë ata do të pajtohen me faktin se dispozitat e kësaj marrëveshje do të interpretohen në një mënyrë që favorizon përmbushjen e plotë të mandatit të të dy institucioneve dhe të mos ndikojë negativisht në punën e tyre.

FILLIMI DHE MBARIMI

12. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga dy palët dhe zgjat deri në atë kohë që përfundohet ose zëvendësohet me ndonjë marrëveshje ose instrument tjetër.

Si dëshmi për këtë, palët kanë nënshkruar këtë marrëveshje më 27.05.2009 (Data)

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit


Hasan Preteni
Drejtor i Agjencionit



Avokati i Popullit


Hilmi Jashari
U.D. Avokat i Popullit